



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1-93

Data 18.07.2023

Br.

Datum

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.06.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi, Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, Edin Hashani, udhëheqës për çështje pronësore Daut Mjeku, shef i sektorit për ekonomi dhe Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun,

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjyba Komunale nr.05/2022, të dt.26.10.2022, sipas sugjerimit të Ministrisë së linjave
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DSHMS-së, nr.-VIII-174, të dt.12.06.2023, për dhënien në debat publik të Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025
5. Shqyrtimi i kërkesës së DAP-së, nr.-III-156, të dt.16.06.2023, Raporti për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Obiliqit 2022
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-770, të dt.16.06.2023, lidhur me Peticionin nga banorët e lagjes "Miniera" Obiliq
7. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025 dhe 2026
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale nr.05/2022, të dt.26.10.2022, sipas sugjerimit të Ministrisë së linjave.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që këtë Plan të ia rekomandojmë Kuvendit komunal dhe në seancë të Kuvendit, do ta japim kontributin tonë si anëtar të Kuvendit.

Sami Ahmeti – Le të kaloj në seancën e Kuvendit dhe atje, do të provojmë me dhënë kontributin tonë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e DEFZH-së, nr.- IV-438, të dt.15.06.2023, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjjoba Komunale nr.05/2022, të dt.26.10.2022, sipas sugjerimit të Ministrisë së linjave.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DSHMS-së, nr.-VIII-174, të dt.12.06.2023, për dhënien në debat publik të Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025.

Enver Gashi – Ky Plan komunal i rekomandohet Kuvendit komunal për një afat të caktuar kohor, do të dalë në debat publik dhe pasi që kthehet edhe ne si anëtarë të Kuvendit komunal, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Jemi gjithsesi që të shkoj në seancën e Kuvendit, rrjedhimisht edhe të dalë në debat publik. Është një prej Rregulloreve të rëndësishme sepse Obiliqi, ka një numër të konsiderueshëm të personave që riatdhesohen vazhdimisht. Do të duhej të caktohet saktë për cilat periudha bëher fjalë, pse në Obiliq konsiderohet se ka të riatdhesuar që disa Agjensione konsiderojnë se nuk kanë qenë kurrë të Obiliqit. Mirëpo, gjithsesi jemi pro sepse është një prej dokumenteve të rëndësishme dhe ne do të provojmë me dhënë kontributin tonë qoftë në debat publik, qoftë në seancë.

Kryesuesje – Edhe herën e parë kur e kemi aprovue një Rregullore të tillë kemi pasë pak mosmarrëveshje me anëtarët e Kuvendit sepse ishte diçka e re dhe nuk e dinin derisa e shpjeguam që ka të bëjë me të gjithë të riatdhesuarit në Kosovë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomandohet Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DSHMS-së, nr.-VIII-174, të dt.12.06.2023, për dhënien në debat publik të Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DAP-së, nr.-III-156, të dt.16.06.2023, Raporti për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Obiliqit 2022.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ti rekomandohet Kuvendit dhe drejtoresha të raportoj për mbarëvajtjen e formimit të Këshillave të fshatrave

Sami Ahmeti – Ka kaluar koga kohë e gjatë që kur janë zgjedhë këto Këshilla të fshatrave.Unë kam pritë që me pasë një raport të punës të këtyre Këshillave të fshatrave, megjithatë edhe ky është i mirëseardhur. Mirëpo, do të ishte mirë që këtij raporti ti shtohet edhe raporti i punës sepse ato Këshilla të fshatrave, veç kanë filluar punën e tyre dhe me ditë se a janë duke funksionue dhe a janë duke e dhënë kontributin ndaj komunitetit ku ata jetojnë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa,me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës së DAP-së, nr.-III-156, të dt.16.06.2023, Raportin për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Obiliqit 2022.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës, nr.-II-770, të dt.16.06.2023, lidhur me Peticionin nga banorët e lagjes "Miniera" Obiliq.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës ti rekomandohet Kuvendit dhe atje do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti –Edhe ne jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-770, të dt.16.06.2023, lidhur me Peticionin nga banorët e lagjes "Miniera" Obiliq.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për shqyrtimin dhe aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026.

Enver Gashi – Ne jemi që kjo kërkesë ti rekomandohet Kuvendit komunal.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi për atë që të shkoj në seancë të Kuvendit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Agron Krasniqi për emërtim të rrugës. Kërkesat tjera, të cilat iu kanë adresue DPUKP-së, nga mbledhja e kaluar duhet që Drejtoria në fjalë të vjen me shkresa dhe ta njofton Kuvendin se çfarë është bërë lidhur me ato kërkesa.

Kjo kërkesë rekomandohet për shqyrtim në DPUKP.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Vegim Krasniqi për dhënien e tokës për investime.

Kjo kërkesë i rekomandohet për shqyrtim DPUKP-së, pastaj Drejtoria në fjalë do ta njoftoj Kuvendin.

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me një rekomandim nga Komiteti për komunitete, për shqyrtimin e mundësisë së kompenzimit të familjeve për shkak të vërshimeve.

Ky rekomandim i dërgohet për shqyrtim Drejtorisë së bujqësisë dhe DSHPE-së.

Pika 9 e rendit të ditës


Kryesuesja – Unë e kam një kërkesë për DPUKP-në, që me shkrim të na dorëzojnë në Kuvendin komunal lidhur me vendimin e lokacionit të ri për rivendosjen e Tregut në njësinë kadastrale. Ju e dini se në bazë të dokumenteve të juaja ne kemi marrë vendim dhe Ministria ka kërkuar se hyrja e vendimit nuk është bazuar në Ligjin nr.04/L-174, për planifikim hapësinor.Ministria e ka kthye vendimin dhe kërkon konkretisht se lokacioni që është paraparë për vendosjen e Tregut për

çka është e destinuar parcela. Pra, saktësisht nga DPUKP-ja, e duam shkresën se ku e keni paraparë, për çka e keni paraparë dhe pjesën grafike për shqyrtim, do të thotë një përgjegje konkrete sa i përket zhvendosjes së Tregut, apo ne duhet ta shfuqizojmë këtë vendim.

Sami Ahmeti – Kërkesa e Komitetit për komunitete ishte kërkesë e mire dhe realisht do të ishte mirë që ta kemi një shpjegim prej drejtorëve të Drejtorive siç e cekët, përndryshe unë ju uroj të gjithëve festën e Bajramit dhe gjithë të mirat.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

